

INFORMATA MBI GRANTIN

Emri i grantit:	Forumi për Zhvillimin e Hapësirave Publike në Lipjan
Instrumenti:	Grant i vogël për projekt
Subjekti zbatues:	Instituti për Edukim Demokraci dhe Art – Edu De’Art
Kontaktet (adresa, emaili, telefoni, website):	Rr. Lidhja e Lezhës, 10 000, Prishtinë edudeart@gmail.com +383 45 119 105
Kohëzgjatja e grantit:	Data e fillimit: 01/05/2026 Data e përfundimit: 28/02/2027
Buxheti total i grantit (EUR):	9,890.00 EUR
Buxheti i mbështetur nga programi EJA Kosovë (EUR):	9,890.00 EUR
Grupet e synuara:	<ul style="list-style-type: none"> Rinia
Shtrirja gjeografike:	Komuna e Lipjanit
Përmbledhje e grantit:	<p>Projekti synon të krijojë një forum qytetar lokal në Komunën e Lipjanit që lidh artistë, të rinj, arkitektë dhe komunitetin me institucionet publike, me qëllim rritjen e pjesëmarrjes qytetare dhe ndikimit në planifikimin komunal përmes ndërhyrjeve artistike në hapësira publike. Brenda një periudhe 10-mujore, projekti do të krijojë një grup punues prej shtatë të rinjsh, do të realizojë analizë të hapësirave publike dhe do të zhvillojë 2–3 propozime konkrete dhe të vizualizuara për ndërhyrje, të cilat do të prezantohen dhe avokohen për përfshirje në planin e punës të komunës. Rezultatet kryesore përfshijnë një mekanizëm funksional bashkëpunimi, dokumente analitike dhe rekomandime konkrete për zhvillim urban dhe kulturor.</p> <p>Aktivitetet kryesore përfshijnë nënshkrimin e një marrëveshjeje bashkëpunimi me komunën, formimin e grupit punues, hulumtimin dhe konsultimet në terren, zhvillimin e koncepteve për ndërhyrje, dokumentimin e procesit dhe organizimin e një dëgjimi publik për prezantimin e propozimeve. Qytetarët dhe grupet e synuara përfshihen në mënyrë të strukturuar gjatë konsultimeve dhe bashkë-dizajnit, duke kontribuar në identifikimin e nevojave dhe zhvillimin e ideve. Projekti do të zbatohet në Lipjan. Përmes këtij modeli, projekti synon të krijojë një praktikë të qëndrueshme të pjesëmarrjes qytetare në nivel lokal, në përputhje me kornizën ligjore për qeverisje dhe konsultim publik.</p>

Bashkëfinancuar nga: